

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-217/11

Prishtinë, 8 maj 2012

Në procedurën ligjore të

B.S.

*Paraqitësi i kërkesës/Ankuesi*

kundër

S.K.

*Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala përgjegjëse në ankesë*

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/116/2011 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA01096), të datë 22 qershor 2011, pas shqyrtimit të mbajtur më 8 maj 2012 morri këtë

## AKTGJYKIM

- 1- Refuzohet si e pabazuar ankesa e B.S. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/116/2011, lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA00256.
- 2- Konfirmohet vendimi KPCC/D/A/111/2011 që i referohet lëndës që është e regjistruar në AKP me numrin KPA01096.
- 3- Obligohet pala ankuese që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej € 90 (nëntëdhjetë euro) brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Me 28 gusht 2007, B.S. (paraqitësi i kërkesës) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku kërkonte ri-posedimin e një lloji të pronës të përshkruar si “banesë” prej “ 8 metrave katrorë”, që ndodhet në Dardani, blloku 1, banesa 4, Prishtinë, Santeja. Paraqitësi i kërkesës ka deklaruar se “hapësira e uzurpuar është pjesë e pronës së tij private për të cilën ai ka paraqitur dokumente të vlefshme dhe kontratën nr. 1193/153568”

Prandaj ai ka kërkuar nga AKP-ja që “prona e tij duhet të lirohet dhe atij t’i jepet ri-posedimi i saj”.

Për ta mbështetur kërkesën e tij, ai ka paraqitur në AKP kontratën e shitblerjes së pronës së paluajtshme të lidhur në Prishtinë më 29 mars 2005. Sipas saj, V.F. ia kishte shitur B.S. (paraqitësit të kërkesës) pronën e paluajtshme të përshkruar si: “banesë dydhomëshe, në Prishtinë, Daradani, blloku 1, Lam 5, banesa nr. 16 me sipërfaqe të përgjithshme pre 57,88 metra katrorë”.

Paraqitësi i kërkesës e ka legjitimuar S.K. si uzurpues të pronës kontestuese në sipërfaqe prej 8 metrave katrorë të kontestueshme.

AKP-ja ka vazhduar notifikimin e lëndës duke vendosur një afishe në mur datën 26 mars 2008. Në raportin e saj, të së njëjtës datë, AKP ka cekur se prona është një depo që është uzurpuar nga E.K., i cili ishte i pranishëm gjatë njofimit të pronës dhe i cili pretendon të drejtën ligjore ndaj saj.

Me vendimin grupor nr. KPKK/D/R/116/2011, të datës 22 qershor 2011, lidhur me kërkesën 01096, KPKK-ja ka konstatuar se kërkesa nuk është në kompetencën e Komisionit të përcaktuar në

nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079. Komisioni ka vërejtur se paraqitësi i kërkesës e kishte blerë pronën në vitin 2005; se pjesa e kontestueshme paraqet një hapësirë të përbashkët të shfrytëzuar nga të gjithë banorët e ndërtesës, se ishte kthyer në depo nga pala përgjegjëse në kërkesë. Sipas këtij të fundit, ky ndryshim është bërë në vitin 1995, por paraqitësi i kërkesës konsideron se ndryshimi ishte bërë në vitin 1999. Komisioni i ka konsideruar këto të dhëna jo relevante sepse paraqitësi i kërkesës e kishte blerë pronën e tij në vitin 2005, prandaj, humbja e pretenduar e posedimit nuk ka mundur të ndërlidhet me konfliktin e armatosur të viteve 1998-1999. Në këtë mënyrë, kërkesa bie jashtë juridiksionit të AKP-së.

Paraqitësi i kërkesës është njoftuar për vendimit me 04 nëntor 2010.

Më 02 dhjetor 2011, ai ka paraqitur ankesë kundër vendimit të lartpërmendur në Gjykatën Supreme.

Pala ankuese e pranon faktin se e kishte blerë pronë në vitin 2005, por pohon se prona ishte në posedim të pronarit të parë (atij prej të cilit ai e kishte blerë pronën) vetëm deri në korrik 1999. Në këtë drejtim, ai i referohet deklaratës së V.F., të datës 12 nëntor 2008, që ka të bëjnë me ankesën. Pas korrikut 1999, prona ishte uzurpuar. Prandaj, pala ankuese konsideron se humbja e pronës ka ardhur si rezultat i konfliktit të viteve 1998-1999 dhe se në këtë asket KKPK-ja e ka vërtetuar gabimisht këtë fakt.

### **Arsyetim ligjor:**

Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit prej 30 ditëve siç parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079.

Megjithatë, ankesa është e pabazuar. Vendimi i KKPK-së është i drejtë, ngase lënda nuk i përket juridiksionit të KKPK-ës.

Sipas nenit 3.1 Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhëresë nga Komisioni për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që dëshmon pronësinë e pronës së paluajtshme private, por edhe që ai nuk është në gjendje aktualisht t'i ushtrojë këto të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

Sipas nenit 2.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 “çdo person i cili **ka pasur** të drejtë të pronësisë, posedim ligjor apo çfarëdo të drejthe tjetër ligjore të shfrytëzimit të pronës së paluajtshme private, i cili në momentin e paraqitjes së kërkesës nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij/saj pronësore për shkak të rrethanave që janë të ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur të viteve 1998/1999, ka të drejtë rikthimi të së drejtës pronësore, si bartës i së drejtës pronësore”.

Interpretimi gramatikor (i shprehjes juridike “ka pasur”) dhe interpretimi historik (konteksti socio-historik në të cilin është krijuar rregullorja – për të siguruar kthimin e të drejtave që kishin ekzistuar në kohën e konfliktit) i këtij neni, që rezulton qartazi se legjislativi nuk ka pasur ndërmend të krijojë një ligj që shërben për zgjidhjen e çdo lloji kontesti pronësore, por vetëm që të krijojë një instrument ligjor për kthimin e të drejtave pronësore personave **të cilët i kanë pasur ato në kohën kur ka shpërthyer konflikti i armatosur i viteve 1998/1999**. Prandaj, çdo e drejtë pronësore e fituar post factum, pas fillimit të konfliktit të armatosur duhet të trajtohet sipas mekanizmave të procedurës së rregullt civile dhe brenda sistemit të gjykatave të rregullta.

Edhe vetë paraqitësi i kërkesës e pranon se e kishte blerë pronën në vitin 2005. Prandaj ai nuk mund të pretendojë humbjen e ndonjë “të drejthe pronësore sipas rrethanave që janë të ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ndodhi në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999”.

Pasi që kërkesa është jashtë juridiksionit të KKPK-së, KKPK-ja nuk ka kompetencë që të vendos rreth pronësisë së paraqitësit të ankesës.

Duke ndjekur të njëjtën linjë – për shkak të mungesës së juridiksionit, Gjykata nuk ka për detyrë që të vendos nëse ankuesi është ose jo pronar i pronës së kërkuar.

### **Shpenzimet e procedurës:**

Në bazë të Aneksit III, nenit 8.4 të UA 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, zbatohet regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, tarifat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (nenet 10.21, dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pasur parasysh se vlera e pronës së kërkuar më arsye mund të vlerësohet deri më €2.000: €60 (€50 + (0,5% e €2.000))

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala ankuese brenda afatit prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi i dorëzohet atij.

**Këshillë juridike:**

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

*Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX*

*Sylejman Nuredini, Gjyqtar*

*Elka Filcheva-Ermenova, Gjyqtare e EULEX-it*

*Urs Nufer, Referent i EULEX-it*